Republika e Kosovës
Republika Kosovo - Republic of Kosovo

Autoriteti Kombëtar i Kualifikimeve
Nacionalni Autoritet za Kvalifikacije
National Qualification Authority

Numër: 01/498
Datë: 01.08.2024

Në mbështetje të neneve 8, 9 dhe 16 të Ligjit Nr. 03/L-060 për Kualifikimet Kombëtare, bazuar në Udhëzimin Administrativ (MASHT) Nr. 35/2014 për Kriteret dhe procedurat për validimin dhe aprovimin e kualifikimeve kombëtare dhe akreditimin e institucioneve që ofrojnë kualifikime në Kosovë, nenit 5 paragrafet 4, 5 dhe 6 si dhe nenit 6 paragrafi 1 të Rregullores Nr. 01/196 e punës e Këshillit Drejtues të Autoritetit Kombëtar të Kualifikimeve, në pajtim me nenin 50 të Ligjit Nr.05/L-031 për Procedurën e Përgjithshme Administrative, Këshilli Drejtues (KD) i Autoritetit Kombëtar të Kualifikimeve (AKK), në mbledhjen e mbajtur me datë 25.07.2024 nxjerr këtë:

# V E N D I M

1. Korrigjohet vendimi Nr. 01/458 i datës 03.07.2024, me të cilin është riakredituar dhe rivaliduar me kusht Instituti Profesional "ATC" SH.P.K, me adresë: Rruga "UÇK" Prishtinë, Republika e Kosovës, për periudhen 3 vjeçare, përkatësisht nga data 03.07.2024 deri 02.07.2027, për ofrim, vlerësim dhe certifikim të kualifikimeve të aporovuar në Kornizën Kombëtare të Kualifikimeve (KKK): Bërës ëmbëlsirash niveli III i KKK, Picamen niveli III i KKK, Ndihmës Kuzhinier niveli III i KKK, Instalues Elektrikë niveli III i KKK. Instituti profesional "ATC" është akredituar dhe validuar me kusht për periudhën 3 vjeçare nga data 03.07.2024 deri 02.07.2027 për ofrimin, vlerësimin dhe certifikimin e kualifikimit të aprovuar në Kornizen Kombëtare të Kualifikimeve (KKK): Kuzhinier niveli IV i KKK.

2. Korrigjimi i vendimit Nr. 01/458 i datës 03.07.2024, bëhet tek paragrafi 2, pika 2.1 e vendimit sa i përket numrin të grupeve të lejuara dhe totalit të kandidatëve që mund të regjistrohen brenda vitit kalendarik dhe i njëjti formulohet/korrigjohet si në vijim:

2.1. **Akreditohet dhe Validohet** me kusht Instituti Profesional "ATC" me adresë: Rruga "UÇK", nr. 62, Prishtinë, Republika e Kosovës, për periudhën tre (3) vjeçare, përkatësisht nga data 03.07.2024 deri 02.07.2027, me kualifikimin e aprovuar në Kornizën Kombëtare të Kualifikimeve (KKK): **Kuzhinier**, Niveli IV i KKK, lloji: Kualifikimet kombëtare profesionale (D) me 25 kredi të AAP. Institucioni mund të realizojë procesin e trajnimit si vijon: Numri i kandidatëve për 1 (një) grup mund të jetë maksimalisht 12 kandidatë. Për një vit kalendarik, lejohen 4 grupe me nga 12 kandidatë, në total 48 (dyzetetetë) kandidatë për vit. Kohëzgjatja e një cikli të trajnimeve është 9 (nëntë) muaj, ku për një vit kalendarik institucioni do të mbaj 1 (një) cikel me nga 4 (katër) grup.

3. Pjesa tjetër e vendimit 01/458 të datës 03.07.2024 mbetet e pandryshuar.
4. Ky vendim hyn në fuqi me nënshkrimin e tij.

**A r s y e t i m**

Instituti Profesional "ATC" SH.P.K pas pranimit të vendimit nr. 01/458 të datë 03.07.2024, përmes telefonit ka kontaktuar me zyrtaren ligjore, ku ka njoftuar se vendimi tek paragrafi 2 pika 2.1 e vendimit është leshuar me gabime teknike, si dhe ka deklaruar se raporti për akreditim dhe ai për validim për kualifikimin Kuzhinier niveli IV i KKK kanë mospërputhje mes vete. Pas pranimit të njoftimit dhe analizimit të raporteve, zyrtarja ligjore ka konstatuar se raporti për akreditim dhe ai për validim për kualifikimin Kuzhinier niveli IV i KKK, në pjesën e dytë tek qartësimi për kushtet e rekomanduara nga ekipi i ekspertëve sa i përket procesit të trajnimit përfshirë grupet dhe totalin e kandidatëve që mund të regjistrojë institucioni brenda vitit kalendarik ishin në mospërputhje me njëri-tjetrin. Prandaj bazuar nga të gjeturat është kërkuar nga kordinatorja e procesit që të kërkohet nga ekipi vlerësues i ekspertëve që të qartësohet se cili është vlerësimi përfundimtar dhe të bëhët përmirësimi i raporteve. Kordinatorja i është drejtuar me email ekipit vlerësues dhe ka kërkuar përmirësimin e raporteve duke kërkuar mendimin e tyre profesionale rreth kësaj çeshtje.

Paneli vlerësues i ekspertëve ka konsideruar se në raporte kanë rrjedh disa gabime teknike dhe kanë përmirësuar raportet bazuar në vlerësimin e tyre profesional. Tutje, AKK ka proceduar raportet e përmirësuara në mbledhjen e Këshillit Drejtues të datës 25.07.2024 dhe të njëjtat pas analizimit janë aprovuar me përmirsimet e bëra nga ana e ekipit vlerësues.

Andaj bazuar në vlerësimin përfundimtar të ekipit vlerësues është rekomanduar që institucioni të realizojë procesin e trajnimit si vijon: Numri i kandidatëve për 1 (një) grup mund të jetë maksimalisht 12 kandidatë. Për një vit kalendarik, lejohen 4 grupe me nga 12 kandidatë, në total 48 (dyzetetetë) kandidatë për vit. Kohëzgjatja e një cikli të trajnimeve është 9 (nëntë) muaj, ku për një vit kalendarik institucioni do të mbaj 1 (një) cikel me nga 4 (katër) grup, ku secili grup mund të ketë maksimalisht 12 kandidatë. Llogaritja është bërë bazuar në kapacitetet e institucionit, si: hapsirat e përgjithshme që institucioni ka në dispozicion, numrin e trajnerëve të angazhuar në procesin e trajnimit (ku për tri profile janë tre trajner të njëjtë), numrin e orëve, kapacitetin e sallave/klasave për mësim teorik (2 salla), kapacitetin e laboratorit për realizimin e pjesës praktike brenda institucionit.

Këshilli Drejtues i AKK-së pas analizimit të vendimit Nr.01/458 të datës 03.07.2024, krahasimit të raporteve paraprake për kualifikimin kuzhinier, si dhe raporteve vlerësuese përfundimtare të ekipit të ekspertëve të dorëzuara në Autoritetin Kombëtar të Kualifikimeve, vendosi si në dispozitiv të këtij vendimi.

**Këshillë juridike:** *Kundër këtij vendimi mund të paraqitet ankesa për rishqyrtim të vendimit sipas nenit 20, pikat 1, 2, 3 dhe 4 të Udhëzimit Administrativ të MASHT për Kriteret dhe procedurat për validimin dhe aprovimin e kualifikimeve kombëtare dhe akreditimin e institucioneve që ofrojnë kualifikime në Kosovë me Nr. 35/2014. Ankesa kundër këtij akti administrativ i dorëzohet KD të AKK, në afat prej 15 ditësh pas lëshimit të vendimit.*

Vendimi i dërgohet:

- Institutit Profesional "ATC" Prishtinë
- Arkivit të AKK- së

Dr. Besim Mustafa

Kryetar i KD të AKK-së